



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË
KRYETARI**

Nr. 14748 prot.

Tiranë, më 20.4.2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim dhe miratim.

KËSHILLIT BASHKIAK

TIRANË

Të nderuar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim relacionin dhe projektvendimin “Për dhënien e ndihmës së menjëhershme në funksion të sigurimit të strehimit të përkohshëm për individët/familjet, pasuritë e të cilëve janë dëmtuar si pasojë e rënies së zjarrit të datës 14.04.2026, në godinën “Arlis Ndërtim”, në rrugën e “Dibrës”.

Me respekt,

KRYETARI

Erion VELIAJ

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI**

Anuela Ristani





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____, 2026

**“PËR
DHENIEN E NDIHMËS SË MENJËHERSHME FINANCIARE PËR SIGURIMIN E
JETËS DHE KUSHTEVE TË PËRKOHSHME PËR INDIVIDËT/FAMILJET E
PREKURA SI PASOJE E ZJARRIT TË DATËS 14.04.2026, NË GODINËN “ARLIS
NDËRTIM”, NË RRUGËN E “DIBRËS”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54 dhe nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, kreut III, pika 1, shkronjës “e”, të vendimit nr. 329, datë 16.05.2012, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, si dhe në vijim të memos të Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes Civile dhe Shërbimeve Ndaj Qytetarit, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë dhënieën e ndihmës financiare të menjëherëshme për sigurimin e jetesës dhe përballimin e kushteve të përkohshme për individët/familjet, pasuritë e të cilëve janë dëmtuar si pasojë e rënies së zjarrit të datës 14.04.2026, në godinën “Arlis Ndërtim”, rruga e “Dibrës”, pranë Farmacisë 10, Njësia Administrative nr. 4.
2. Masa e ndihmës financiare sipas pikës 1, të këtij vendimi, është në shumën 40,000 (dyzet mijë) lekë në muaj, dhe jepet deri në sistemimin përfundimtar në banesën e rikonstruktuar.
3. Individët/familjet, me qëllim përfitimin e ndihmës financiare, detyrohen të plotësojnë dhe të depozitojnë pranë Njesisë Administrative/Lagjes përkatëse ku janë të regjistruar, dokumentacionin si më poshtë:
 - Dokument identifikimi i aplikuesit dhe dokumentacion që vërteton të drejtën e pronësisë mbi objektin e dëmtuar;
 - Certifikatë familjare;
 - Deklaratë për vërtetësinë e të dhënave, sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi;
 - Vërtetim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, nga i cili rezulton se anëtarët madhorë nuk zotërojnë banesë tjetër në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku ka ndodhur fatkeqësia. Përrjashtimisht nga ky kriter janë individët/familjet që kanë më shumë se një pronësi në godinën objekt të këtij vendimi;
 - Vërtetim për llogarinë bankare.
4. Njësia Administrative/Lagjia përkatëse, pasi verifikon saktësinë e dokumentacionit sipas pikës 3, të këtij vendimi, harton listën emërore të përfituesve dhe e përcjell atë, së bashku me

dokumentacionin shoqërues, çdo muaj pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes Civile dhe Shërbimeve ndaj Qytetarit. Kjo e fundit, pasi konstaton përmbushjen e kritereve, e përcejell dokumentacionin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, me qëllim likuidimin e pagesës.

5. Ndhima financiare do të monitorohet çdo muaj nga Njësia Administrative në juridiksionin territorial të së cilës ndodhet godina objekt i këtij vendimi, e cila duhet të njoftojë Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar për ndërprerjen e kësaj pagese, në rast se këto individë/familje sistemohen përfundimisht në banesën e rikonstruktuar. Në rast se gjatë monitorimit konstatohen se ndihma është përfituar në mënyrë të padrejtë nga këto individë/familje, strukturat përgjegjëse marrin masa për nisjen e procedurave për kthimin e vlerës së pagesës.

6. Drejtorja e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile dhe Shërbimeve Ndaj Qytetarit, raporton pranë Këshillit Bashkiak listën e përfituesve çdo 3 muaj.

7. Efektet financiare të pikës 1 të këtij vendimi do të përballohen nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë në programin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Mbrojtjes Civile, artikulli 606, transfertë tek individë, miratuar në buxhetin e vitit 2026.

8. Ngarkohen, Drejtorja e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile dhe Shërbimeve Ndaj Qytetarit, Drejtorja e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Njësia Administrative/Lagjet, si dhe çdo strukturë tjetër që mund të afektohet nga parashikimet e këtij vendimi, për ndjekjen dhe zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

MEGI FINO

ANEKSI 1

DEKLARATË E VËRTETËSISË SË INFORMACIONIT MBI PASURITË E PALUAJTSHME

Unë i nënshkruari,.....(Emri Atësia Mbiemri), me numër identifikimi personal sipas letërnjoftimit, i lindur më (datë/muaj/vit), në qytetin/fshatin e, banues në (adresa e deklaruësit bashkëlidhur edhe dokumenti i pronësisë), deklaroj me vullnet të lirë dhe nën përgjegjësinë time të plotë ligjore, se unë dhe anëtarët madhorë të familjes time, përveç pasurisë së dëmtuar si rezultat i fatkeqësisë natyrore:

nuk kam/kemi

kam/kemi

të drejta pronësie / bashkëpronësie apo posedimi të ligjshëm mbi pasuri të tjera të paluajtshme me funksion banimi, në territorin administrative të Bashkisë Tiranë.

- I gjithë informacioni i deklaruar në këtë deklaratë është i vërtetë dhe jam në dijeni se për çdo informacion të rremë, hiqet e drejta për tu trajtuar .
- Jam i vetëdijshëm se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i kesaj deklarate mund të pasjellë fillimin e procedurave për përgjegjësinë civile dhe penale sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
- Pranoj që të kryhet verifikimin i të gjithë informacionit të dhënë.

DEKLARUESI/T

MARRËSI I VETËDEKLARIMIT

Emër Mbiemër / Firmë

Emër Mbiemër / Firmë / Vulë

SHËNIM: Në rast deklarimi të rremë ky formular përbën provë për përgjegjësi penale sipas kuadrit ligjor në fuqi

RELACION

“PËR

DHËNIEN E NDIHMËS SË MENJËHERSHME NË FUNKSION TË SIGURIMIT TË STREHIMIT TË PËRKOSSHËM PËR INDIVIDËT/FAMILJET, PASURITË E TË CILËVE JANË DËMTUAR SI PASOJË E RËNIES SË ZJARRIT TË DATËS 14.04.2026, NË GODINËN “ARLIS NDËRTIM”, NË RRUGËN E “DIBRËS”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54 dhe nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, kreut III, pika 1, shkronjës “e”, të vendimit nr. 329, datë 16.05.2012, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile dhe Shërbimeve Ndaj Qytetarit, parashtron relacionin sa më poshtë vijon:

Referuar Kreut III, pika 1, shkronjat “e” dhe “ë”, të vendimit nr. 329, datë 16.05.2012, të Këshillit të Ministrave, përcaktohet se njësia e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet organeve të saj përkatëse, ka kompetencën për hartimin dhe shqyrtimin e kërkesave për dhënie e ndihmës së menjëhershme financiare, me qëllim sigurimin e jetës, shëndetit dhe kushteve minimale të përkohshme të jetesës për qytetarët e prekur nga fatkeqësitë, si dhe për përballimin e situatave emergjente të krijuara.

Nga të dhënat faktike rezulton se, në datën 14.04.2026, në një prej godinave të ndërtuara nga shoqëria “Arlis Ndërtim”, në zonën e njohur si “Farmacia 10”, ka rënë një zjarr me përmasa të konsiderueshme, i cili është përhapur me shpejtësi duke shkaktuar dëmtime të konsiderueshme në strukturën e pallatit, përfshirë fasadën dhe ambientet e brendshme të banimit. Si pasojë e këtij zjarri, një numër i konsiderueshëm apartamentesh janë dëmtuar rëndë, duke i bërë të papërdorshme për banim dhe duke lënë familjet përkatëse pa strehim dhe në kushte emergjente.


Në këto rrethana, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore të njësisë së vetëqeverisjes vendore për mbrojtjen e qytetarëve dhe garantimin e kushteve minimale të jetesës, Bashkia Tiranë ka vlerësuar të nevojshme ndërhyjen me ndihmë financiare të menjëhershme, me qëllim sigurimin e strehimit të përkohshëm dhe përballimin e situatës emergjente të krijuar.


Gjithashtu, propozohet që masa e ndihmës së menjëhershme financiare për individët/familjet të jetë në referim të vendimit nr. 3, datë 22.01.2026, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë për tre zonat e Bashkisë Tiranë, për individët/familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë”, zona në fjalë klasifikohet në zonën B, ku vlera maksimale e subvencionit të qirasë përcaktohet në masën 40,000 (dyzet mijë) lekë në muaj.

Për sa më sipër, në analizë të kuadrit ligjor në fuqi dhe të rrethanave faktike të konstatuara, rezulton se ndërhyrja e Bashkisë për dhënie e ndihmës së menjëhershme financiare është jo vetëm e bazuar në ligj, por edhe e domosdoshme për garantimin e mbrojtjes së jetës, shëndetit dhe dinjitetit të qytetarëve të prekur. Situata e krijuar si pasojë e ngjarjes së zjarrit përbën një emergjencë që kërkon reagim të shpejtë dhe proporcional nga organet e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me kompetencat dhe detyrimet e tyre ligjore.

Për sa më sipër, i parashtrojmë Këshillit Bashkiak, në cilësinë e organit vendimmarrës, miratimin e projektvendimit “Për dhenien e ndihmës së menjëhershme financiare për sigurimin e jetës dhe kushteve të përkohshme për individët/familjet e prekura si pasojë e zjarrit të datës 14.04.2026, në godinën “Arlis Ndërtim”, në rrugën e “Dibrës”.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana juaj,

Znj. Urjada Bele 
Specialist, Sektori i Monitorimit dhe Administrimit të Strehimit

Z. Ronaldo Hasa 
Specialist, Sektori i Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit

Znj. Zoje Vathi 
Specialist, Sektori i Politikave të Kompensimit nga Fatkeqësi Natyrore


Znj. Joana Shahini 
Përgjegjëse, Sektori i Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit


Znj. Ornela Kurti (Basha) 
Përgjegjëse, Sektori i Monitorimit dhe Administrimit të Strehimit

Znj. Eleana Jupaj 
Përgjegjëse, Sektori i Politikave të Kompensimit nga Fatkeqësi Natyrore

Znj. Edina Rrokaj 
Drejtor, Drejtoria e Programeve Sociale dhe Monitorimi të Strehimit

Znj. Elona Gogaj 
Drejtor, Drejtoria e Mbrojtjes Civile

Z. Erion Çaka 
Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit

Z. Dritan Dango 
Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile dhe Shërbimeve Ndaj Qytetarit

Znj. Berta Piro 
Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar

Z. Eldi Hoxha 
Sekretar i Përgjithshëm

Znj. Vasilika Vjero
Nënkryetar i Bashkisë Tiranë